



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 28 paragrafi 2 pika (l) lidhur me nenin 29 paragrafi 2 pika (d), të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, e në zbatim të kërkesës së Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr. 020-337/7 të datës 08.07.2025, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë -----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M
Për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-31320

Neni 1

Me këtë vendim shfuqizohet vendimi, 01-Nr-016-31320, i datës 30.05.2025, më të cilin është dhënë në shfrytëzim afatgjatë prona e paluajtshme e komunës, konkretisht parcela kadastrale “P-72116046-00545-6”.

Neni 2

E në mbështetje të nenit 10 të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019”, e në zbatim të nenit 33, pika 1, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, **Pezullohet** procedura e shqyrtimit dhe miratimit të Raportit dhe Rekomandimit 01-Nr-016-24991 të datës 29.04.2025, të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, konkretisht për parcelën kadastrale “P-72116046-00545-6”, deri në konstituimin e organeve të reja të Komunës pas zgjedhjeve lokale.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI